



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Administratës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201801521/5**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2018**

**Lënda :** *Rekomandohet ndërprerja e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015 të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1841, datë 18.07.2017, me objekt midis të tjerave : "Detyrim për kthim të hollash".*

**Drejtuar :** **Përmbaruesit Gjyqësor Privat**  
Z. Lefter Canaj  
Pranë: Studio Përmbarimore "L.D.C." Sh.p.k.  
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Vila nr.8/1, Kati 1.

**Për dijëni:** **Bukurije Gega**  
Adresa: Post pritje

**TIRANË**

**K Ë T U**

Z. Canaj !

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim rastin e prezantuar prej Bukurije Gega etj, të cilët ankohen ndaj jush për kryerje veprimesh përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1841, datë 18.07.2017, në kushtet e pezullimit të ekzekutimit të këtij vendimi nga Gjykata e Lartë me Vendimin nr. 79, datë 27.02.2018.

Sipas Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, rezulton të jetë vendosur midis të tjerave për :

*"... Të paditurit B.G., M.G., K.Xh. (G.), F.G., S.G. F.K., F.G., A.K., S.K., F.T., Sh. T. detyrohen të kompesojnë solidarisht në raport me pjesët e tyre takuese në secilën pasuri, paditësat S.G. dhe M. G., respektivisht:*

a) S.G. në shumën totale 1.132.825 Lekë si vlerë totale e kompesimit për pasuritë me nr.7/308, nr.9/205, nr.7/307, nr. 7/528; nr.7/128.

b) M.G. në shumën totale 1.132.825 Lekë si vlerë totale e kompesimit për pasuritë me nr.7/308, nr.9/205, nr.7/307, nr. 7/528; nr.7/128,

brenda 1(një) viti nga dita e marrjes së këtij vendimi forme të prerë, duke depozituar të paditurit secilën prej shumave përkatëse të lekëve në bankat e nivelit të dytë me veprimtari në Qytetin e Tiranës, në llogaritë bankare të paditësive S.G. dhe M.G.”.

Marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor të lartpërmendur ka ndodhur më datë 18.07.2017, kur Gjykata e Apelit, Tiranë ka lënë në fuqi vendimin gjyqësor të sipërcituar.

Mbi kërkesën e palës kreditore për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, Vendimit Gjyqësor nr.6841/U, datë 21.09.2015, konstatohet se, ju, keni kryer veprime përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.6841, datë 21.09.2015, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa respektuar afatin 1(një) vjeçar për dorëzimin e detyrimit solidar prej debitorëve. Në këto kushte, Gjykata e Lartë, me rastin e prezantimit të kësaj situatë prej debitorëve në rekursin e depozituar, ka vendosur me Vendimin nr.79, datë 27.02.2018, për :

*“Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr.1841, datë 18.07.2017, të Gjykatës së Apelit, Tiranë”.*

Ende pa u shprehur gjykata për rekursin e kryer prej debitorëve B.G., etj, apo heqjen e masës së sigurisë, sikurse cituar më sipër, ju, keni rifilluar kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1841, datë 18.07.2017, duke dërguar debitorëve aktin nr.531/8 prot, datë 25.07.2018 *“Njoftim procedural”*. Sipas këtij akti, ftohen palët që të arrijnë marrëveshje brenda 7(shtatë) ditëve për caktimin e çmimit të pasurisë së sekuestruar nga ana juaj, e cila, më tej, do të duhet t’i nënshtrohet ankandit. Një prej pasurive për të cilat ftohen palët të arrijnë marrëveshje në caktimin e çmimit është ajo e regjistruar në regjistrin e ZVRPP, Tiranë, me nr. 9/121, vol 18, faqe 184, Zona Kadastrale 8370, e cila nuk figuron e sekuestruar në Aktin (Urdhërin) *“Për vënien e sekuestros konservative”* nr.531/7 prot, datë 22.02.2018, drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Kryerja e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv në kushtet kur është urdhëruar me vendim gjykate pezullimi i ekzekutimit nuk mund të vlerësohet në përputhje me parashikimin e kryer në nenin 615/a të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin thuhet midis të tjerave, se :

*“Ekzekutimi pezullohet*

*a) me vendim të gjykatës*

*b) .....”.*

Veprimtaria juaj në procesin e ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit, Vendimit nr.6841/U, datë 21.09.2015, dhënë për zbatimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për arsyet e përmendura, nuk mund të vlerësohet në përputhje me detyrat e përmbaruesit gjyqësor privat sikurse parashikuar në nenin 32 të ligjit nr.10031, date 11.12.2008, *“Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”*, i ndryshuar. veprimtaria juaj në procesin e ekzekutimit

të titullit ekzekutiv të lartpërmendur do të jetë objekt prezantimi para Ministrit të Drejtësisë.

Për të mundësuar rivendosjen në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në parashikimin e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, të ligjit nr.8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen” :

### **REKOMANDON**

*Ndërprerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 6841, datë 21.09.2015 të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1841, datë 18.07.2017, me objekt midis të tjerave : “Detyrim për kthim të hollash”.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kërkohmë mundësimin e kthimit të përgjigjes brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Me besim në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**